

LIGJI NR. 06/L-120

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-047

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-047

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin. nr. 05/L-047.

Neni 2

Neni 191 i ligjit bazik, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 191

1. Me gjobë prej pesëmijë (5,000) euro deri në njëzetmijë (20,000) euro dënohet për kundërvajtje çdo person juridik ose biznes individual, nëse në kuadër të veprimtarisë ose bashkëpunimin të biznesit:

1.1. kryen cilindo veprim të shmangies të masave efektive teknologjike të mbrojtjes;

1.2. kryen veprimin e heqjes apo të ndryshimit të informacionit elektronik të realizimit të të drejtave.

2. Me gjobë prej njëmijë (1,000) euro deri dymijë (2,000) euro dënohet personi i cili kryen kundërvajtjen e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 3

Neni 192 i ligjit bazik, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 192

1. Me gjobë prej pesëmijë (5,000) euro deri njëzetmijë (20,000) euro dënohet për kundërvajtje çdo person juridik ose biznes individual:

1.1. që nuk i dorëzon shoqatës kolektive kompetente informacionin lidhur me llojet dhe numrin e pajisjeve të shitura ose të importuara për fiksime vizuale ose të zërit, pajisjet fotokopjuese, transmetuesit bosh të zërit apo të imazhit, si dhe informacionin mbi fotokopjet e shitura të cilat janë të nevojshme për llogaritjen e kompensimit të veçantë;

1.2. që nuk i dorëzon shoqatës kolektive kompetente raporte ose informacione apo programe në mënyrën dhe afatet, siç është përcaktuar nga ky ligj, të rëndësishme për

Ilogaritjen e kompensimit të veçantë.

2. Me gjobë prej njëmijë (1,000) euro deri në dymijë (2,000) euro dënohet personi që kryen kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 4

Neni 193 i ligjit bazik paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:

Neni 193

2. Me gjobë prej njëmijë (1,000) deri dymijë (2,000) euro, dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni edhe personi përgjegjës i shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave.

Neni 5 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L-120
30 maj 2019

Shpallur me dekretin Nr. DL-124-2019, datë 21.06.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi

LIGJI NR. 06/L - 119

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/22 PËR KINEMATOGRAFINË

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/22 PËR
KINEMATOGRAFINË**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.2004/22 për Kinematografinë.

Neni 2

Neni 55 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 55

Me gjobë prej dhjetmijë (10.000) euro deri në njëzetëmijë (20.000) euro, gjobitet për kundërvajtje distributori, përkatësisht pronari ose qiramarrësi i një kinemaje që e ndryshon qëllimin e veprimtarisë së kinemasë pa pëlqimin e QKK sipas nenit 8 të këtij Ligji.

Neni 3

Neni 56 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 56

1. Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në dhjetmijë (10.000) euro gjobitet për kundërvajtje shfaqësi, përkatësisht distributori:

1.1. Që shfaqë një film të pa pajisur me lejen për shfaqje publike sipas nenit 9 të këtij ligji ose që i është refuzuar dhënia e lejes sipas nenit 10 paragrafi 2 të këtij Ligji;

1.2. Që lejon të miturëve nën katërbëdhjetë (14) vjeç të kenë qasje në kinema kur filmi është i pajisur me lejen e kategorisë "B", ose të miturve nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç sipas nenit 10, paragrafi 1, pika (b) dhe (c) të këtij Ligji;

1.3. Që shfaqë një film para orës 22:00 me përmbajtje në kuptim të nenit 10 paragrafi 3 të këtij Ligji.

Neni 4

Neni 57 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

Neni 57

Me gjobë prej dyqind (200) euro deri në pesëmijë (5.000) euro gjobitet për kundërvajtje, producenti që nuk vepron sipas nenit 54 paragrafi 1 të këtij ligji.

Neni 5

Neni 58 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

Neni 58

Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në dymijë (2.000) euro gjobitet për kundërvajtje anëtar i jurisë vlerësuese që ka fshehur informacionin ose faktin që paraqet pengesë për të qenë anëtar i jurisë vlerësuese ose që ka marrë pjesë në mbledhjen e jurisë vlerësuese përkundër pengesave në nenin 43 paragrafi 6 të këtij ligji.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L - 119
30 maj 2019

Shpallur me dekretin Nr. DL-125-2019, datë 21.06.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi